



Pranuar / Dorezuar Prinjepe/Pradato Received/Delivery	23.02	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org /Unit	SKAMSHACK	801/2021	
Nr Prot Pr Prot Prot No			
Shtesa Protog Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			112



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A Nr. 23/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari, Arben Mehmeti - anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.23/2021, të datës 21.01.2021, së ankuesit me adresë banimi rruga „ Bedri Gjini”, nga Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

1. Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën Nr. 23/2021, e datës,21.01.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.12.2020, me numër A. Nr. 133/2019, ka nxjerr vendim me të cilin ka detyruara Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ta bëjë shqyrtimin e ankesës të datës 08.01.2019, se ankuesit

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Mitrovicës, me datë 08.01.2021, me numër protokollit 01-112/12-0001324-2, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi i pakënaqur me vendin e datës 08.01.2021, të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, për mes postes së Kosovës, parashtron ankesë e cila ankesë është pranuar me datën 21.01.2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë,27.01.2021 me numër protokollit 316/2021, ka dërguar përgjigjen në ankesën tek Komuna e Mitrovicës, ndërsa me datë 12.02.2021, me numër protokollit 618/2021, Komuna e Mitrovicës ka dërguar përgjigjen në ankesë tek Këshilli.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.23/2021, e datës 23/2021 me numër protokollit 253/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 28.03.2013; vendim i datës 06.01.2021, për pensionimin e ankuesit Vendimi i datës 01.12.2020, me A. Nr. 133/2019, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.01.2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën A nr.

133/2019, e datës 26.02.2019, me numër protokoll 997/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 01.02.2005; Kontrata e punës e datës 10.03.2010; Akt emërimi i datës 28.03.2018; Ankesa e datës 19.12.2018; Ankesë e datës 08.01.2019 drejtuarin Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave ;Përgjigje në kërkesë e datës 12.02.2019; Akt emërim i datës 28.03.2013; Kontrata e punës e datës 10.03.2010; Krekës për përgjigje në ankesë e datës 26.02.2019, me numër protokoll 1457/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se në akt emërimin, nga emërimin "Zyrtar për planifikim", duhet të vendoset "Zyrtar i lartë për Planifikim", Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse nga shkresat e lendes del se ankuesi ka arritur moshën e pensionimit sipas vendimit të datës 06.01.2021, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur, në bazë të dispozitat të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë**". Sepse në rastin konkret nga shkresat e lendes del se ankuesi me datë 16.01.2021, me numër protokoll 01-118/02-0000640/21, Kryetari i Komunës së Mitrovicës ka nxjerr vendim me të cilin i ka përfunduar marrëdhënja e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, prandaj kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se objekti i ankese për shqyrtim është bërë i pamundur për tu shqyrtuar sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 23/2021



Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

